

PROCESVERBAL

Procesvërbal i mbajtjes së diskutimit publikë për shqyrtimin e propozim rregullores për ndarjen e bursave për student të komunës së Lipjanit i mbajtur me 05.03.2020 në sallën e kuvendit të komunës së Lipjanit.

Prezent: znj. Elmaze Behluli Drejtoresha e DKA-së
Vlora Krasniqi – anëtare e komisionit për hartimin e rregullores
Islam Kaleshi – anëtarë i komisionit për hartimin e rregullores
Brahim Duriqi- Procesmbajtës

Takimin e hapi Drejtoresha e DKA-së znj, Elmaze Behluli përshëndeti të pranishmit dhe falenderoj për pjesmarrje dhe në vazhdim dha një rezume rreth rregullores duke theksuar edhe rëndësin e kësaj rregullore. Se DKA është njëra ndër prioritete e komunës së Lipjanit dëshmon fakti se për këtë qëllim për këtë vit komuna ka ndarë mjete financiare në shumë prej 40,000 € dhe në vazhdim për ç' do vit mvarësishtë prej kapaciteteve financiare do të ndaj mjete për financimin e studentëve perms bursave .Ju keni mundësi që perms këtij diskutimi ti jepni vërejtjet kritikate dhe sygjerimet e juaja ose ti drejtoheni me shkrim komisionit per hartimin e rregullores.

Vlora Krasniqi si anëtare e komisionit dha sqarimet rreth hartimit të rregullores duke ju drejtuar të panishmëve që të paraqesin sugjerimet e tyre eventualisht ndonjë plotësim apo vërejtje.

Shkëlqim Aliu – Pyetje: Në këtë rregullore a mundë të përfshihen edhe studentët që kan regjistruar masterin?

Vlora Krasniqi: Ne do ti marrim parasysh të gjitha sygjerimet e juaja dhe në fund do të vendosim për formën dhe kriteret e rregullorës.

Synai Garipi –Pyetje: Amundë të futet në kriteret që për komunitetin romë, ashkali dhe egjiptian të ketë ndonjë përparsi?

Vlora Krasniqi: Ne do ta marrim në konsiderat këtë kërkesë megjith atë rregullorja është e bazuar në parimet e mosdiskriminit të çfarëdo forme qoftë ajo.

Shkëlqim Aliu, A do të ketë ndonjë klasifikim të bursave me përparsi për drejtimet profesionale deficitare?

Vlora Krasniqi: Kjo qështje është e parapar në kriteret e rregullores.

Fadil Sylejmani: Student që potencoj drejtimet profesionale sidomos fakultetit të edukimit mendoj se duhet tu ipet përparsi. Neve nuk duhet shumë të na bëj përshtypje qështja sociale apo aspekti social sepse për këtë qështje duhet të gjendet ndonjë formë tjetër e financimit, mirpo përmes kësaj rregullore duhet ti stimulojm më te për studentët e mire.